

VENDIM
Nr. 480, datë 30.7.2021

**PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 404, DATË 30.6.2021, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR
FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT TË RRUGËVE ‘MIQËSIA’ DHE ‘AZEM
HAJDARI – GJELBËRIMI’, TË NDODHURA BRENDA KONTURIT TË ZONËS SË
RE PËR ZHVILLIM, ZONA 4, NJËSIA ADMINISTRATIVE DURRËS, BASHKIA
DURRËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 16, dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 404, datë 30.6.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rikonstruksionit të rrugëve ‘Miqësia’ dhe ‘Azem Hajdari – Gjellbërimi’, të ndodhura brenda konturit të zonës së re për zhvillim, zona 4, Njësia Administrative Durrës, Bashkia Durrës”.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe